

E/I nderuar/a z./znj. _____,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 543 datë 01.10.2024, ka vendosur shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit **trevjeçarë të formimit fillestar**, një ndër të cilët/at jeni edhe ju.

Pozicionet e lira të shpallura nëpërmjet këtij vendimi janë si më poshtë:

- i) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
- ii) **tre** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- iii) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan
- iv) **pesë** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
- v) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
- vi) **katër** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
- vii) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
- viii) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
- ix) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
- x) **katër** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- xi) **tre** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
- xii) **një** pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Përmes këtij njoftimi, ftoheni të përcaktoni, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata ndër ato si më lart, në të cilat kërkonti të caktoheni në pozicion.

Gjithashtu, krahas deklaratës me shkrim ku të përcaktoni, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata në të cilat kërkonti të caktoheni në pozicion, ju duhet të deklaroni situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gjykatat si më lart.

Afati i fundit i aplikimit është data **02.10.2024, ora 13.30**, ndërkohë që mungesa e aplikimit nuk pas sjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion.

Për më shumë, referohuni në Vendimin nr. 543 datë 01.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilin e gjeni edhe bashkëlidhur këtij e-maili.